

Fletë udhëzuese në lidhje me rimbursimin e shpenzimeve në përputhje me nenet 1835, 1835a të Kodit Civil për kujdestarë vullnetarë¹

Kujdestaria do të ushtrohet parimisht pa pagesë (në mënyrë vullnetare). Megjithatë si kujdestar/e juve mund t'ju rimbursohen shpenzime, të cilat ju lindin gjatë angazhimit tuaj.

1. Rimbursim aforfe i shpenzimeve, neni 1835a i Kodit Civil

Në përputhje me nenin 1835a të Kodit Civil rimbursimi i shpenzimeve përmban aktualisht një vlerë aforfe prej 400,00 € në vit. Për të kërkuar këtë shumë **nuk** është e nevojshme paraqitja e faturave pranë sektorit përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë (Gjykatës për Çështjet Familjare – ose Gjykatës për Çështjet e Kujdestarisë).

Rimbursimi bëhet çdo vit, për herë të parë një vit pas caktimit të kujdestarit. Në lidhje me këtë ju udhëzoheni, që e drejta për të kërkuar përcaktimin e rimbursimit aforfe shuhet, nëse ju nuk e paraqisni kërkesën tuaj deri më 31.03 të vitit tjetër. Këtu bëhet fjalë për një **afat prekluziv/përrjashtues**, pas përfundimit të së cilit nuk mund të merret më parasysh kërkesa juaj.

Shembull:

Viti i kujdestarisë përfundon më 15.08.2009. Kërkesa duhet të parashtrohet deri më 31.03.2010.

Me kërkesën tuaj do t'ju jipet dhe formulari përkatës. Kërkesa mund të parashtrohet dhe pa formë.

2. Kompensimi/Kthimi i shpenzimeve, neni 1835 i Kodit Civil

Në rast se shpenzimet tuaja e kalojnë shumë prej 400,00 €, atëherë ju duhet t'a vërtetoni këtë në mënyrë të hollësishme (dita e vizitës, shpenzimet e udhëtimit, telefonatat e kryera, fatura postale me të dhënat e të adresuarit etj.). Për udhëtimet me veturën personale do t'ju kompensohet një vlerë prej 0,42 € për çdo kilometër të udhëtuar.

Të drejtat për të kërkuar kompensimin e shpenzimeve të veçanta shuhet, nëse ju nuk e kërkonit atë (kompensimin) brenda 15 muajsh pas lindjes së tyre kundrejt personit, që është nën kujdestari, pranë sektorit përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë (Gjykata për Çështjet Familjare – ose Gjykatës për Çështjet e Kujdestarisë).

3. E drejta e zgjedhjes

Mund të bëhet kërkesa vetëm për rimbursimin aforfe – pa vërtetim individual – **ose** për rimbursimin e shpenzimeve. Zgjidhni ju lutem alternativën më të përshtatshme. **Zgjedhja juaj është e detyrueshme.**

4. Proçedura e rimbursimit

Kur personi, që është nën kujdestari nuk disponon **mjete financiare**, pra ai/ajo ka të ardhura rrjedhëse nën tarifën e ndihmës sociale si dhe nuk ka asnjë pasuri, vlera e së cilës është mbi pasurinë e lejueshme në rastin e përfitimit të ndihmës sociale, atëherë me kërkesën tuaj shpenzimet tuaja do të rimbursohen nga arka e shtetit.

Pasuria e paprekshme përmban si rregull shumë prej 5.000 €.

Kur personi, i cili është nën kujdestarinë ligjore disponon të **ardhura** më shumë se të mjaftueshme apo ndonjë **pasuri**, atëherë ju mund t'i merrni shpenzimet tuaja me vërtetim individual (shih lart pika 2.) **pa parashtrimin e një kërkesë** menjëherë pas lindjes së tyre nga

¹ Kjo fletë udhëzuese vlen nga ana kuptimore për afërsisht dhe për kujdestarinë, kujdestarët dhe kujdestaret.

pasuria e personit, që është nën kujdestarinë ligjore. Nëse ju keni zgjedhur për rimbursimin aforfe të shpenzimeve (shih lart pika 1.), atëherë ju mund t'i merrni ato pas përfundimit të vitit të kujdestarisë nga pasuria e personit, që është nën kujdestarinë ligjore. Verifikimi do të bëhet më vonë në kuadër të paraqitjes së llogarisë ose të raportimit.